



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME

Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-23163/24 datë:26.08.2024



Npi – 01/294 datë: 27.08.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 27.08.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 27.08.2024 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: znj.Yllkë Fejzullahu drejtoresh e DKA-së; z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF-së; z.Xhavit Fejza dhe znj.Arianita Beqa-Rraci nga UNMIK-u; z.Muharrem Haziri nga OSBE-ja; znj.Vlora Hyseni nga zyra për Informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 02.07.2024,
2. Raporti i auditimit të ZKA-së për pasqyrat financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2023,
3. Plani i veprimtimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023,
4. Raporti buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024,
5. Draft-Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (për diskutim publik),
6. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për emërimin e Rugëve dhe Shesheve,
7. Informatë nga DKA për përfundimin e vitit mësimor 2023-2024 në Komunën e Shtimes e me thekës të veçantë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian,
8. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës. Në vazhdim, Konstatoj Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 02.07.2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 02.07.2024.**

Pika 2

Raporti i auditimit të ZKA-së për pasqyrat financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për këtë pikë fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Përshëndetje, e them me përgjegjësi se është ndër raportet më të mira dhe është me opinion i kualifikuar si i pa kualifikuar. Raporti i auditimit i ka tri pika kryesore. E para Auditori i ka gjetur 15.500 euro si llogari të arkëtueshme në PVF. E dyta është keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë prej 23.221 euro. Dhe pika e tretë janë obligimet kontigjente, prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në vlerë prej 616.269 euro. Gjithësejt i kemi 8 rekomandime nga Zyra Kombëtare e Auditimit, tri rekomandime janë të reja dhe pesë janë të vjetra. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të bëj përpjekje që të përgjigjem.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje për të gjithë, më vjen mirë që sot kemi një prezencë shumë më të mirë se herave tjera. U vonova pak e po kërkoj falje. Pyetje kamë te mungesa e projekteve ekzistuese dhe mos vendosja e tyre në platformën e prokurimit? Te subvencionimi e pashë një mosmenagjim të mirë sipas auditorit?

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Propozoj që ta kalojmë këtë pikë e të dalim në pikën e radhës ku bënë pjesë edhe pyetja e Besnikut.

Pika 3

Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për këtë pikë fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Pra siq e thash i kemi 8 rekomandime nga Zyra Kombëtare e Auditimit, tri rekomandime janë të reja dhe pesë janë të vjetra ose të përsëritura. Materialin e keni marrë me kohë dhe po besoj e keni lexuar prandaj unë po i theksoj vetem ato që janë më të rëndësishme, (shih dokumenti).

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë propozoj që me i rekomandu Kuvendit për miratim. Në vazhdim konstatoi Kuorumi prej 6 anëtarëve të Komitetit për Komunitete prezent në mbledhje.

* Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -VIII- për vitin 2024 të mbajtur me 27.08.2024, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, që ta miratoi Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023.

Pika 4

Raporti buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për këtë pikë fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Raportin buxhetor e kemi obligim ligjor për ta prezantuar në Kuvend, i kemi pas 30 ditë për me dërguar në Kuvend pasi ta përgatisim dhe ne e kemi dërguar në afat. Baza ligjore është në Ligjin për financat publike dhe përgjegjësitë. Shpenzimi ose më mirë me thënë realizimi i buxhetit për Janar – Qershor në përqindje është 45.43 %. Sa i përket Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim janë 8.000 euro ndërsa janë shpenzuar 3.000 euro. Tash më tutje nuk e di se sa kanë mbetur saktësisht pa u shpenzuar. Nëse ka ndonjë pyetje konkrete do të përgjigjem.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë propozoj që ti rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë këtë raport buxhetor për 6 mujorin e parë 2024.

z.Besnik Seferi; ZKKK-ja mund të them se nuk është funksionale, u bënë dy vite e gjysëm që ne po e diskutojmë këtë çështje. Përveç përgjegjësit të zyrës aty duhet me qenë edhe dy zyrtarë. Unë nuk jamë i kënaqur me shpenzimet që janë bërë. Unë pajtohem për miratimin e rekomandimit por a ka vërejtje ka.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, kemi shumë kërkesa dhe nevoja nga banorët, dhe me të drejtë po pyesin se kurë do të kryhen këto kërkesa. Qytetarët kanë shumë nevojë qoftë për barna ose për gjëra të tjera. Prandaj unë po bëj thirrje që këto kërkesa të trajtohen sa më parë dhe tu ipet përgjigje. Shpresoj që Kryetari do të bëj një zgjidhje sepse vërtetë boll u bë më me këto kërkesa.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Siç e dini këtu ka qenë Ministri i Pushtetit Lokal, dhe përveq të tjerash na ka premtuar se së shpejti do të bëjmë një zgjidhje për sa i përket përgjegjësit të ZKKK-së. Në vazhdim Konstatoj Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -VIII- për vitin 2024 të mbajtur me 27.08.2024, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, që ta miratoi Raportin Buxhetor të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Qershor, 2024, me vërejtjen që të funksionalizohet, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.**

Pika 5

Draft-Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (për diskutim publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për këtë pikë fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Sipas Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, ne jemi të obliguar për me e prezantuar në Kuvend Planin – buxhetor për vitin 2025. Materialin edhe për këtë pikë e keni marrë me kohë. Plani Buxhetor duhet të shkojë në diskutim publik, sepse edhe ky është obligim ligjor. Qarkoren e dytë buxhetore e kemi pranuar më 15.08.2024. Buxheti nuk ka lëvizur shumë në krahasim me vitin e kaluar por kjo nuk nënkupton që pas diskutimit publik mund të ndryshojë në ndonjë kategori ekonomike duke marrë parasysh arsyeshmërinë e kërkesave të qytetarëve dhe mundësitë buxhetore. Plani Buxhetor për vitin 2025 është planifikuar të jetë 10.777.180 euro. Nëse ka pyetje urdhëroni unë do të përgjigjem.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Më parë siç e dini i kemi pas disa kërkesa. Meqenëse i kemi dy vende të lira të punës unë kam propozim që njëri me qenë për ZKKK-në. Dhe një propozim tjetër e kamë për DKA-në që të funksionalizohen qendrat për mësim.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Ne kemi rekomandim nga MEF-i që vendet e lira të punës të gjitha duhet të shkojnë te Çerdhet për fëmijë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; A është fakt i mjaftueshëm për ta arritur një vend të punës, fakti që është i paraparë me rregullore.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues nga OSBE; Përshëndetje, më falni që po ua marr kohën, meqenëse nuk jamë anëtarë i KPK-së. Në muajin Janar kemi pas një takim pune me Kryetarin e Komunës. Te ZKKK-ja nuk është mbuluar me zyrtarë as me përgjegjës. Jam duke menduar se çka do të del nga ky takim, sepse ju e dini se ne duhet të raportojm. Pastaj si është puna me koeficientët sepse edhe kjo ndikon në numrin e të punësuarve si zyrtarë.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Vendet e punës të ZKKK-së nuk është se u janë marrë ato janë të lira dhe vetëm duhet me u plotësuar. Nuk plotësohen vendet e punës në Çerdhe me numrin e punëtorëve të ZKKK-së, ka vende të tjera të lira në 2024. Vendet e punës te ZKKK-ja janë të veçantë.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; E vërteta është se në ZKKK-në ekziston një Ushtruese e Detyrës në këtë zyre, nuk është se nuk ka fare zyrtarë aty, por është krejt diçka tjetër që jemi të pa kënaqur me punën e sajë.

z.Arton Demiri; Krejt rinia e Shtimes kanë pas me dalë në protesta për këtë çështje, të zyrës. Ne Ushtrueses së Detyrës i themi dada Elfet, nga respekti që kemi për te, por ajo është për me dhënë Çertifikata e jo për zyrën e komuniteteve.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatoj Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -VIII- për vitin 2024 të mbajtur me 27.08.2024, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, që ta miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik Draft-Buxhetin e Komunës së Shtimes për vitin 2025, me kërkesën që Drejtoria Komunale e Arsimit ta merr parasysh qështjen e Buxhetimit të funksionalizimit të dy Qendrave Mësimore për Komunitetin Rom dhe Ashkali.**

Pika 6

Propozim-Vendim per formimin e komisionit per emërimin e Rrugëve dhe Shesheve

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Propozimi për formimin e këtijë komisioni është që të jetë i përbërë nga 7 persona, e kërkesa ime është që njëri prej tyre me qenë prej komuniteteve, mbase le të hiqet njëri nga komuniteti intelektual.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatohet Kuorumi prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -VIII- për vitin 2024 të mbajtur me 27.08.2024,** unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, që ta miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik Draft-Buxhetin e Komunës së Shtimes për vitin 2025, me kërkesën që Drejtoria Komunale e Arsimit ta merr parasysh qështjen e Buxhetimit të funksionalizimit të dy Qendrave Mësimore për Komunitetin Rom dhe Ashkali.

Pika 7

Informatë nga DKA për përfundimin e vitit mësimor 2023-2024 në Komunën e Shtimes e me thekës të veçantë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për këtë pikë fjalën ja dha Yllkë Fejzullahut.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Përshëndetje, informatën e keni marrë të shkruar me kohë dhe po besoj që e keni lexuar, (shih dokumentin). Vëmendjen e juaj dua ta përqendroj te problemi i braktisjes së shkollimit në shkollat e komunës tonë. Në vitin 2024 dmth. deri tani i kemi 6 nxënës që e kanë braktisur shkollën të komunitetit jo shumicë. Faktorët që ndikojnë në braktisjen e shkollës mund të jenë të ndryshëm qofshin ekonomik, social, emigrim etj. Por është edhe një faktor që ka të bëjë me martesat e hershme, dhe për këtë duhet ndërmarrë hapa nga të gjithë për ta parandaluar.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, vitin e kaluar kemi qenë shembull për të mirë sepse nuk kemi pas asnjë nxënës që ka braktisur shkollimin. Po flas për OJQ "Ballkan Sonflower". I kemi sistemuar në secilën paralele nga dy nxënës. Braktisja e shkollimit është edhe për shkak të liberalizimit të vizave. Pyetje për drejtoreshën, këta 6 nxënës a keni informata a janë kthyer në mësim apo qka ka ndodhur me ta?

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Nuk kamë informata të detajuara më tej për këto raste se qka ka ndodhë, por mundem me ua dërguar informatat me momentin që ato i sigurojmë.

Pika 8

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; Unë po dua që të diskutojmë për ato shtatë kërkesat që janë paraqitur në zyrën e komuniteteve, se pse nuk kanë përgjigje.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë i kisha shkruar një rekomandim U.D-së për ti trajtuar ato kërkesa. Në vazhdim Konstatohet Kuorumi prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -VIII- për vitin 2024 të mbajtur me 27.08.2024,** unanimisht vendosi t'i Rekomandoj, Ushtruesit të Detyrës të Shefit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim pranë Komunës së Shtimes, që ti shqyrtoi dhe adresoi kërkesat (7) që i janë adresuar ZKKK-së, e që ende nuk është vendosur për to.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Meqenëse diskutime nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:57h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Zëvendës Kryesuesi i Komitetit
Muhamet Mehmeti